



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 1000/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “EJONA”SHPK – Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: GOE“Rima Engineering group”& “Rima Enginnering”shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit: 616-20-2517-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, më datën: 15.12.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “EJONA”SHPK – Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit: 616-20-2517-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

**II. VËRTETOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit: 616-20-2517-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me

Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “EJONA”SHPK – Pejë, aprovohet si pjesërisht bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “EJONA”SHPK – Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.11.2020 me nr. 1000/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me nr. të prokurimit: 616-20-2517-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 07.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Pretendimi nr.1**, Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, pas pranimit të vendimit të PSH-se, e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit në fjale dhe sipas udhëzimeve të dhëna në raportin e ekspertizës dhe vendimi të PSH-se nr. 618/20, AK-ja ka kërkuar sqarime lidhur me mungesën e

dokumentacionit dhe informacionit qe ka munguar ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate.

Konkretisht AK-ja, ka kerkuar deshmit lidhur me referencat e stafit te cilat ne përgjigje te kërkesës se AK-se, OE i rekomanduar për kontrate me datën: 30.10.2020, i ka dorëzuar te gjitha deshmit sipas kërkesës se AK-se.

Eksperti shqyrtues, pasi i ka analizuar deshmit e prezantuar ne sistemin e E-prokurimit, deshmit e dorezuara nga i rekomanduari dhe ne përgjigje te pretendimit te OE ankues, vlerëson se i rekomanduari për kontrate ka dorëzuar deshmi ne kundërshtim ne paragrafin 3 te nenit 72 te LPP-se, për faktin se disa nga deshmit/referencat qe i ka prezantuar mban datën 15.10.2020 dhe po ashtu ka dëshmi te cilat e kanë datën e fiksuar 30.10.2020.

OE ankues po ashtu pretendon se ne deshmit e dorëzuara me datën: 30.10.2020, OE i rekomanduar ka dorëzuar edhe një reference e cila nuk ka qene fare ne listën e kontratave, eksperti shqyrtues, vlerëson se qëndron ky pretendim, mirëpo sqaron se nuk ka asnjë efekte fakti qe kjo reference nuk është e shënuar ne listën e kontratave, por fakti qe e njëjta deshmi mban datën: 15.10.2020, e bën te pavlefshëm dhe ne kundërshtim me nenin 72.3 te LPP-se dhe njeherit sqaroj se këto dëshmi nuk është dashur te merren parasysh nga ana autoriteti kontraktues.

Sa i përket pretendimit se stafi profesional nuk e përmbush kërkesën e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate lidhur me përvojën e stafit, qëndron për faktin se përkundër mundësisë se dhëne gjate faze se rivlerësimit OE i cili është edhe me çmim me ulet nuk ka arritur te dëshmoj se i njëjti i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Ne fund eksperti shqyrtues, vlerëson se pretendimet ankimore te OE ankues te parashtruar ne ankesën e tij janë te qëndrueshme dhe njeherit sqaroj se dokumentet e prezantuar nga i rekomanduari për kontrate janë ne kundërshtim me nenin 72.3 te LPP-se ku thuhet: **Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.**

Ne rastin konkrete deshmit mbajne daten 15.10.2020 dhe 30.10.2020 qe i bie se disa nga keto deshmi jane mbi pesë (5) muaj pas dorezimit/hapjes se ofertave dhe njeherit eksperti shqyrtues, sqaron se disa nga keto deshmi i bashkangjes si prova me kete raporte.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i

propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet **si e bazuar**, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne **rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 11.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 11.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit Visar Basha .

Sipas provave të siguruara nga ne, kjo lende duhet te kthehet ne rivlerësim dhe OE e shpallur fituese "Rima Enginnering" duhet te shpallet i eliminuar nga ky aktivitet .Ndersa OE i rekomanduar per dhenie te kontrates te shpallet "EJONA" SHPK pasi qe jemi i vetmi OE i pergjegjshem ne kete aktivitet.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimin e parë ankimor, Paneli shqyrtues, konstaton se AK-ja, pas pranimit të vendimit të PSH-se, e ka kthyer ne rivlerësim aktivitetin e prokurimit ne fjale dhe sipas udhëzimeve të dhëna ne raportin e ekspertizës dhe vendimi e PSH-se nr. 618/20, AK-ja ka kërkuar sqarime lidhur me mungesën e dokumentacionit dhe informacionit qe ka munguar ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate.

Konkretisht AK-ja, ka kërkuar dëshmitë lidhur me referencat e stafit te cilat ne përgjigje te

kërkesës se AK-se, OE i rekomanduar për kontrate me datën: 30.10.2020, i ka dorëzuar te gjitha dëshmitë sipas kërkesës se AK-se.

Paneli shqyrtues, pasi i ka analizuar dëshmitë e prezantuara ne sistemin e E-prokurimit, dëshmitë e dorëzuara nga i rekomanduari dhe ne përgjigje te pretendimit te OE ankues, vlerëson se OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar dëshmitë ne përputhje me paragrafin 3 te nenit 72 te LPP-se dhe nenin 39 te RUOPP.

Edhe përkundër faktit se disa nga dëshmitë/referencat qe i ka prezantuar OE mbajnë datën 15.10.2020 dhe po ashtu ka dëshmi te cilat e kanë datën e fiksuar 30.10.2020, Paneli shqyrtues konstaton se OE përmbush kriterin e përcaktuar nga AK pasi qe dëshmitë/referencat e dorëzuara dëshmojnë faktin se stafi ka kryer punët para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate.

Neni 72.3 i LPP-se përcakton *"Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive"*, **qe ne rastin konkret do te thotë se referenca e lëshuar deklaron se stafi ka kryer punët para datës se fiksuar ne dokumentet e tenderit. Prandaj, Paneli sqarues konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar pasi qe nuk duhet te merret parasysh data kur është lëshuar dokumenti por duhet te merret parasysh data e cila përcakton se kur është kryer puna.**

Ne lidhje me pretendimin e dytë ankimor ku, OE ankues pretendon se ne dëshmitë e dorëzuara me datën: 30.10.2020, OE i rekomanduar ka dorëzuar edhe një reference e cila nuk ka qene fare ne listën e kontratave, Paneli shqyrtues, konstaton se qëndron ky pretendim ankimor, mirëpo sqaron se nuk ka asnjë efekte fakti qe kjo reference nuk është e shënuar ne listën e kontratave, pasi qe OE i rekomanduar për kontrate përmbush kriteret edhe pa llogaritur ketë reference.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në

konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK – “KK Prishtinë”

1x1 OE - “EJONA” SHPK-Pejë.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.